

EKSPOZE E PUNIMIT
DIPLOMACIA E MBRETIT ZOGU I I-rë 1928-1939

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SHKENCAVE TË HISTORISË

NGA

BEHAR BESHIRI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

SHKURT, 2022

EKSPOZE

DIPLOMACIA E MBRETIT ZOGU I I-RË 1928-1939

NGA

BEHAR BESHIRI

Mentori: Selim Bezeraj, Prof. Ass. Dr.

Historia e Shqipërisë lidhet ngushtë me procesin e pavarësisë kombëtare dhe diplomacisë së Mbretit Zogu i I-rë në politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit në periudhën e viteve 1928 – 1939. Prandaj, Shqipëria nuk ka pasur një tërësi politike më vete, por ka qenë pjesë e perandorive që përfshinin brenda tyre shumë etni. Në periudhën e mesjetës shqiptarët nuk arritën të krijojnë njësi të pavarur shtetërore në nivelin e mbretërisë. Në shekullin XVIII në kuadër të Perandorisë Osmane shqiptarët me Pashallëkun e Shkodrës krijuan pothuajse të parin shtet kombëtar në Ballkan të drejtuar nga Bushatllinjët. Ky ishte një rast i shkëlqyer për sigurimin e pavarësisë dhe ngritjen e një mbretërie, ky ishte shumë më e lehtë për fuqitë evropiane të njihej pushteti dhe shteti i Shqipërisë, por nuk ndodhi. Në periudhën e krizës lindore 1875 – 1881 shqiptarët krijuan Lidhjen e Prizrenit që arriti të formonte qeverinë e përkohshme, thuajse të pavarur nga Porta e Lartë. Edhe në këtë kohë, as Kongresi i Berlinit dhe as ndonjëra nga fuqitë evropiane nuk e njohën çështjen shqiptare. Megjithatë, më 28 nëntor 1912 u shpall pavarësia e Shqipërisë, e cila përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptarë. Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë dhe ngritja e flamurit kombëtar në Vlorë nga Ismail Qemali ishte një nga kthesat e vuajtjeve për çlirim kombëtar. Më 29 korrik 1913 Konferenca e Ambasadorëve e gjashtë Fuqive të Mëdha të Evropës mori vendimin që e shpallte Shqipërinë autonome, sovranë dhe trashëgimore. Padyshim, në historinë politike të Shqipërisë zë një vend të rëndësishëm ndikimi i konsiderueshëm të Ahmet Zogut, i cili në rini ishte ftuar në kongresin e thirrur nga Ismail bej Qemali. Nga ky çast filloi edhe diplomacia e tij të shtrirë në një periudhë të gjatë kohore.

Qëndrimi i Mbretit Zog ndaj aleancave pushtuese, e udhëhequr nga Mbreti Zogu i I-rë bëri të ditur se do të kultivonte marrëdhënie të mira me të gjitha shtetet, dhe veçanërisht me fqinjët e sajë dhe do të zbatonte të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë aleancën e përfunduar me aleatën e saj të madhe dhe fisnike Italinë. Qëndresa e tij u nxit nga Anglia, e cila synonte të detyronte Romën të mos ndërmerre veprime pa pëlqimin e Londrës, si dhe

Jugosllavisë, rivale e Italisë në Shqipëri. Por këto shtete bënë lojë të dyfishtë, edhe kur ishte puna të mbronin hapur Shqipërinë, nuk e bënë këtë për të mos u prishur me Italinë. Pasi u shteruan të gjitha përpjekjet politike e diplomatike nga ana e italianëve, qeveria e Romës bëri kërcënimin ushtarak. Anglia dhe Franca kërkuan shpjegime Italisë dhe kërkuan asaj të mos e acaronte më tepër gjendjen. Mbreti, në këtë gjendje tepër të vështirë, kur burimet financiare të shtetit kishin shteruar dhe kur shtetet e mëdha të Evropës, si dhe shtetet ballkanike, nuk i dhanë ndihme dhe përkrahje, nuk kishte as forca, as edhe mundësi për ta përballuar deri në fund këtë kërcënim të egër të qeverisë së Musolinit dhe u detyrua të pranonte normalizimin e marrëdhënieve me Italinë. Italia fashiste kishte kohë që përgatitej për pushtimin e Shqipërisë qoftë në mënyrë “paqësore” nëpërmjet presioneve në fushën politike, ekonomike, ushtarake dhe financiare, qoftë edhe me forcën e armatosur. Pasi dështuan përpjekjet e vazhdueshme dhe ultimatumit i fundit për ta detyruar Mbretin Zog, Parlamentin dhe qeverinë shqiptare që të nënshtroheshin, qeveria italiane vendosi të përdorë forcën e armatosur për të pushtuar Shqipërinë. I gjendur përpara provës më të vështirë të kohës, Zogu ideoi qëndresën. Mbretëria nxiti gjithashtu edhe qëndresën popullore, manifestimet, mitingjet, etj., me qëllim që të krijohej një sfond gjithëpërfshirës kombëtar qëndresë dhe për krijimin e një mjedisi sa më të harmonizuar të ndërgjegjesimit kombëtar kundër pushtimit.

Në këtë rrjedhojë ngjarjesh, u zhvillua intensivisht diplomacia e Mbretit të Shqipërisë, Ahmet Zogu i I-rë, e cila me ndikimet e brendshme dhe të jashtme të vendit kishte për synim të qarta që Shqipërinë të mbante sa më larg luftërave. Gjithashtu, të përfitonte nga kontradiktat e fuqive të mëdha dhe atë të fqinjëve për ta mbajtur Shqipërinë jashtë konflikteve bashkëkohore me qëllim për të bërë një shtet të zhvilluar ekonomikisht, politikisht dhe ushtarak, e nga ana kulturore sipas modeleve të demokracive perëndimore.

Kjo diplomaci ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve dhe analistëve vendas dhe të huaj në periudhat para dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Diplomacia e Zogut, s'është bërë objekt i një monografie të mirëfilltë, por janë trajtuar vetëm aspekte të veçanta të asaj diplomacie. Lidhur me figurën e Ahmet Zogut I-rë Mbretit të Shqiptarëve, më gjerësisht kanë dhënë opinionet autorët italianë, ku këta me shkrimet e tyre ndjehet haptazi antishqiptarizmi. Një varg publikime të shkruara nga diplomatët italian, të cilët kishin vepruar në Shqipëri, problematikën e Zogut e trajtonin nga këndvështrimi shkencëtar si jo objektivitet. Për më tepër, pikëpamjet e atyre autorëve italian që kishin shërbyer si diplomat në Shqipëri shfaqnin miratimin e politikës shtetërore Italiane për aneksimin – pushtimin e Shqipërisë.

Prandaj, ky punim do të shtjelloj në mënyrë objektive diplomacinë nën udhëheqjen e Mbretit të Shqipërisë Ahmet Zogun në periudhën 1928 – 1939. Ky studim bazohet në një qasje kronologjike mbi diplomacinë e Mbretit Zogu i I-rë, gjithashtu, studimi trajton historinë e Shqipërisë mes viteve të përmendura, më pas biografinë e Mbretit Zogu I-rë me zhvillimin e misionit ndër-luftarak dhe raportet politike. Diplomacia e Ahmet Zogut ka luajtur një rol të rëndësishëm gjatë të kaluarës së Shqipërisë. Periudha e regjimit të Ahmet Zogut në Shqipëri shquhet me luftërat dhe rezistencat e tij, që kur ishte kryekomandant i forcave të armatosura të Matit deri në pozitën e Ministrit të Brendshëm. Më pas vjen periudha e rrëzimit të pushtetit në Shqipëri dhe emërimi i tij si Kryeministër. Duke vazhduar në aspiratat e tija për ta krijuar Republikën e Shqipërisë, parlamenti e zgjedh Ahmet Zogun edhe si President të parë të Shqipërisë. Kurse, periudha kulmore e tij ishte me shpalljen e Shqipërisë monarki, ku hipi në fronin e Mbretit, e cila theksohet me marrëdhëniet dhe paktet e nënshkruara me shtetet fqinjë dhe vitet e migrimit. Prandaj, qëllimi i këtij punimi ishte të analizoj politikën e brendshme dhe të jashtme të Ahmet Zogut, me theks të veçantë vitet 1928 – 1939 në Shqipëri.

Struktura e punimit të ndarë në kapituj vë në pah si objektiv kryesor pasqyrimin e qëndrimit të Ahmet Zogut ndaj Shqipërisë e vendeve fqinje, Ballkanin dhe më gjerë, të hulumtuar nga autorë dhe historian më eminent të historisë moderne për Mbretin e Shqiptarëve Zogu i I-rë.

Punimi fillon me një parathënie e cila trajton në mënyrë të përgjithshme temën e studiuar në këtë punim. Në mënyrë specifike kjo pjesë pasqyron qëllimin kryesor të këtij punimi, e cila synon të arrij që të pasqyroj diplomacinë e Mbretit Zogu i I-rë. Punimi e arsyeton veten për hulumtimet nga autorë dhe historian më eminent të historisë moderne për Mbretin e Shqiptarëve Zogu i I-rë. Kjo pjesë e punimit përfundon me shpjegimin e organizmit të strukturës së punimit.

Kapitulli parë, fillon me një hyrje, që shpjegon historikun e jetës së Ahmet Zogut I-rë. Po ashtu, në këtë kapitull paraqitet diplomacia shqiptare nën udhëheqjen e Ahmet Zogut, si kryeministër dhe si president i Shqipërisë, duke analizuar dhe shpjeguar politikën e jashtme dhe të brendshme të Zogut. Kapitulli trajton çështjen e krijimit të Mbretërisë Shqiptare, ku në theks të veçantë shpjegon vendosjen e legjislacionit sipas modelit demokratik perëndimor, që punonte Zogu i I-rë intensivisht për ngritjen e shtetit. Kapitulli trajton temën e ndjeshme të shpalljes Mbret me paratë që morri nga Shqipëria dhe dhuratat e Hitlerit për martesën me Geraldinën.

Kapitulli i dytë, shtjellon fillimet diplomacisë së Mbretit Zogu i I-rë në raport me rajonin. Po ashtu, në këtë kapitull i kushtohet vëmendje edhe çështjes së Kosovës dhe në mbrojtje të shqiptarëve Çamë në Greqi. Ku nga përkeqësimi i situatave në Ballkan merrte gjithnjë pamjen e lëvizjeve agresive greke kundër pakicës shqiptare dhe Çamërisë.

Kapitulli i tretë, përshkruan diplomacinë e Mbretit Zogu i I-rë me Europën. Kapitulli shtjellon rolin e zyrës së jashtme të Britanisë në Shqipëri (Foreign Office), ku përshkruhen marrëdhëniet diplomatike midis Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe. Në fund kapitulli përmbyllet me lajthitjet dhe lidhjet me Mustafa Qemal Ataturkun, për njohjen e shtetit shqiptar.

Kapitulli i katërt, reflekton qëndrimin e Mbretit Zogu i I-rë ndaj aleancave pushtuese. Kapitulli në mënyrë të detajuar shpjegon presionet italiane të presidentit Musolini. Kapitulli vazhdon të shpjegoj qëndrimet e Zogut I-rë ndaj shantazheve të italianëve. Italia po përgatitej për pushtimin e Shqipërisë qoftë në mënyrë paqësore po qoftë edhe me forcën e armatosur. Prandaj, kapitulli trajton temën e arratisjes së Ahmet Zogut dhe pushtimit të Shqipërisë nga italianët. Po ashtu kapitulli reflekton rezistencën shqiptare ndaj pushtuesve italian. Dhe kapitulli përmbyllet me qëndrimin e Mbretit Zogu i I-rë për politikat britanike në Ballkan.

Kapitulli i pestë, shtjellon pjesën përfundimtare të punimit dhe reflekton konkluzionet dhe diplomacinë e Mbretit të Shqipërisë Ahmet Zogu në periudhën 1928 – 1939.

Pjesa e fundit e punimit pasqyron burimet dhe literaturën e shfrytëzuar për temën e diskutuar, ku si literaturë janë shfrytëzuar burimet e shumta të cilat janë paraqitur në pjesën e referencave bibliografike.

Bazuar në studimin e mësipërm, argumenti kryesor i këtij punimi ishte analiza e sundimit të Mbretit Zogu i I-rë në Shqipëri gjatë viteve 1928 – 1939. Prandaj, ky punim trajtoi diplomacinë e Mbretit Zogu i I-rë dhe vjen në përfundim se ai shihet si një personazh i aftë për të stabilizuar Shqipërinë duke krijuar kushtet e nevojshme për krijimin e ndërgjegjes individuale shqiptare, përgjegjësisë kombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.